

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kosova është gati, me Irlandën synohet fitorja
ADRESA	https://www.koha.net/futboll/kosova-eshte-gati-me-irlanden-synohet-fitorja
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 00:55:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 17:38:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	331857fd2d84defb5e8c3a8c9f8ce8ef1ceec9dd2a78317c4bffcfcce2078b7a9
TEKSTI	0c4c653397d42c77c7b7c95fe7bde553b77e689171ba30e1d8b7c52023b8712
PAMJA	deab98fbdf98e529c77a3f2851d98e8d0044da34469af9ec01c1d726ddb0330

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	187caeb76a575124bbceb76c9c32d804adb2eee067fe81cbe4ed2f4aaf52afba
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	dda7d23b558402c926cd6fed567bb6eba8126329f8a189914308aeb661b57cd2
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/187caeb76a575124bbceb76c9c32d804adb2eee067fe81cbe4ed2f4aaf52afba>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

FUTBOLL

Kosova është gati, me Irlandën synohet fitorja



Nga: Faton Polisi

23 shtator 2026 19:38

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanalin tonë zyrtar në Viber

Kosova nuk është përballur asnjëherë me Irlandën në futboll. Franco Foda nuk ka pasur asnjë përballje me Irlandën edhe sa ishte përzgjedhës i Austrisë.

Por selektori i "Dardanëve", Foda, beson se ka përgatitur mirë ekipin për ndeshjen kundër irlandezëve.

Ndeshja e Grupit B3 të Ligës së Kombeve ndërmjet Kosovës dhe Irlandës luhet të enjten në stadiumin "Fadil Vokrri". Nis nga ora 20:45.

"Deri tani nuk kam përvojë personale me Irlandën. Është ndeshja e parë që e zhvilloj ndaj saj. Është diçka e re. Ne jemi përgatitur dhe jemi të gatshëm të luajmë ndaj Irlandës", ka thënë Foda në konferencë për shtyp, të mërkurën.

Foda thekson se kanë analizuar ndeshjet e Irlandës. Tekniku gjerman thotë se Kosova synon fitore.

Edhe



Futboll • 6 o. më parë

Foda tregon nëse do të ketë ndryshime eventuale në formacion

"Sigurisht se i njohim kualitetet e Irlandës. E dimë se si ka luajtur në ndeshjet e fundit. Ne i kemi analizuar me shumë vëmendje të gjitha ndeshjet. Avantazhi është se luajmë në shtëpi. Dëshirojmë t'i fitojmë të gjitha ndeshjet, por nesër do të shihet si do të shkojë loja. Ndoshta mund të pajtohemi edhe me barazim. Qëllimi është të fitojmë", është shprehur Foda.

Ai ka analizuar edhe anët e forta të Irlandës. Thotë se Irlanda është ekip shumë atletik dhe ka dinamikë në lojë.

"Prandaj presim që të ketë duele një kundër një. Mirëpo ne duhet të mundohemi t'i zbatojmë detyrat dhe të vazhdojmë tutje".

Kosova për ndeshjen ndaj Irlandës mund të mbështetet edhe në dy lojtarët e rinj, Erblin Osmani dhe Dion Kaçuri. Të dy mesfushorët kanë marrë leje për t'u paraqitur me Kosovën pas ndërrimit të përfaqësuesve. Osmani ka luajtur për të rinjtë e

Arbëri.

Vuçiqi në Asambleenë e OKB-së falënderon shtetet që s'e kanë njohur Kosovën

Arbëri.

Vela e cilëson gjysmak vendimin e Gjykatës Kushtetuese

Kulturë.

"Valle tradicionale të Opojës" në hap të ruajtjes së thesareve popullore

Showbiz.

Harvey Weinstein dënohet me 15 vjet burgim për sulm seksual

Basketboll.

Peja mposhtet thellë, kualifikimi thuhet se i pamundur

Botë.

Zelensky në OKB: Putini është "pacienti zero", prej të cilit lufta vazhdon të përhapet

Gjermanisë, kurse Kaçuri për të rinjtë e Zvicrës.
Foda ka bërë të ditur se sulmuesi i Hoffenheim, Fisnik Asllani është gati për lojë.

“Erblin Osmani e ka treguar veten shumë mirë në ushtrime dhe ka dëshmuar pse e kemi ftuar në Kombëtare. Ka treguar aftësi të jashtëzakonshme teknike. Për moshën që e ka është shumë i fuqishëm fizikisht. Fisnik Asllani është në top-formë dhe njëkohësisht e ka treguar veten shumë mirë në ushtrime. E dimë që në ekipin e tij ka pasur pak minuta në dispozicion. Por besoj që Asllani do të dalë në fushë”, thotë Foda.

Edhe



Futboll • 6 o. më parë
Avdullahu: Jemi gati kundër Irlandës, s’kemi pse të fshihemi

Ai ka njoftuar se Vedat Muriqi do të jetë kapiten i Kosovës, ndërsa zëvendës i tij Mërgim Vojvoda.
Foda ka thënë se synimi i Kosovës është vendi i parë në grup. Por pranon se Austria është favorite.

“Na presin ndeshje të vështira dhe dihet që në këtë grup është Austria favorite. Ne si Kombëtare kemi shumë qëllime të larta. Në radhë të parë dëshirojmë të mbesim në Ligën B. Pastaj nëse paraqitemi mirë të vazhdojmë dhe të ngrihemi”.

Mesfushori Leon Avdullahu foli me respekt për Irlandën. Por thotë se nuk i frikësohen asaj.

“Besoj që këtë respekt e kemi merituar nga Irlanda dhe nuk kemi pse të frikësohemi. Besoj që do të jetë lojë e vështirë, shumë fizike. Por i kemi bërë përgatitjet shumë mirë, e kemi analizuar lojën shumë mirë për të qenë gati nesër”, ka thënë Avdullahu.

Avdullahu ka theksuar se Irlanda luan lojë të shpejtë dhe fizike.

Edhe



Futboll • 7 o. më parë
Foda: Kundër Irlandës qëllim fitorja

“Presim lojë fizike, të shpejtë. Kemi respekt për Irlandën. Do të jemi gati dhe nuk kemi pse të fshihemi”, ka thënë lideri i mesfushës “dardane”.

Avdullahu ka përgëzuar lojtarët e rinj që kanë vendosur t’i bashkohen Kosovës. Ka thënë se “Kosova shkon duke u përforcuar”.

#KOSOVA

#KOSOVA - IRLANDA

Artikuj të ngjashëm



Futboll • 7 o. më parë
Foda dhe Avdullahu flasin para ndeshjes me Irlandën



Futboll • 22 sht 2026
Kosova vazhdon përgatitjet për duelin ndaj Irlandës

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografite, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njësisë që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

Marketing

Politika e privatesisë

Kushtet e përdorimit

Udhëzim për përdorimin e IA-së

Cilësimet e privatesisë dhe cookies

Perkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL EN DE FR ES GR SR TR MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh
Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.